



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komuniës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 19.08.2021, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Afrim Dina.

Kryesuesi – Fillimi i tij më lejoni të përshtënës, nënkyetarin Fatmir Iska, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtoret e drejtive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim vendimit për ridestinimin e mjeteve të mbeturë nga buxheti i viti 2021;
3. Informatë mbi implementimin e planit për investime në hapësirat e hapura publike në komunën e Rahovecit;
4. Të ndryshme.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, nëse ju pajloheni që për mbledhjen e rregullt te Kuvendit që ta kemi edhe një pikë shtesë, që është Shfuqizimi i vendimit Nr. 0127/2009, të datës 02.07.2010 për dhënien ne shfrytëzim te pronës komunale. Para se me aprovua rendin e ditës, e kisha fituar shefin e zyrës ligjore z. Isak Hoti për paraqitjen e pikës.

Isak Hoti – Përshtëndetje për te gjithë. Pra, fjalë është për vendimin për dhënien ne shfrytëzim kompanisë turke me seli ne Prizren për ndërtimin e fabrikës se tjegullave, gjë për të cilën pika e katërt na obligon që ne me marr veprime te mëtujeshme sepse thotë që nëse shfrytëzimi i tokës ne asfat prej tre viteve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi nuk ndërtón objektin apo nuk kryen punë te konsiderueshme ne ndërtimin e objektit industrial, Komuna e Rahovecit do të merr vendim mbi incimin e procedurës për denoncim të kontratës për dhënien tokës shtetërore ne shfrytëzim në kushte dhe mënyrën e caktuar sipas dispozitive të ligjit të tokës ndërtimore me vendim të KK.Rahovec. Faktikisht na obligon edhe ligji i ri përkatesisht nen 19 paragrafi 5 i ligjit për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, kur thotë e drejta e shfrytëzimit të pronës të paluajtshme nuk mund të bartet ne shfrytëzim te personat e tretë, që faktikisht ky ka nisë të bëj lojëra rrëth kësaj çështje pasi vinë njerëzit këtu edhe thonë se e kam marr prej Likosit edhe kërkon që ta merr, që faktikisht ne listën poseduese figuron që ai është shfrytëzues i tokës edhe ne nuk mundemi me ja lanë këtë të drejtë pasi nuk ka të drejtë me luajt me pronën e huaj. Po ashtu edhe te kushtet e kontratës e obligon kryetarin e komunës që ta njofton kuvendin për nisje të procedurës për shkëputje të kontratës. Kështu që për më gjérësisht e kisha lanë edhe për kuvend këtë punë mirëpo kjo kompani neve na ka paditë për shkak se nuk ka mundur me zhvillua procedurën që me fillua punën atje, ku kanë shtrua padi pranë gjykatës themelore ne Prishtine, departamenti për çështje ekonomike

me datë 11.09.2015 për kompensimin e dëmit sipas tij me shumë prej 376,215 euro që na ka paditur. Kjo gjykatë në aktgjykimin nr.394/15 të datës 02.10.2017 ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e tij. Dhe paditësi ka ushtruar ankesë me datë 26.10.2017 në shkallën e dytë gjykata e apelit ne departamentin për çështje ekonomike me aktgjykim 266/2017 te datës 25.09.2019. Pra edhe ketë ankesë te paditësit e ka refuzuar gjykata si e pa themeltë dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës se parë. Por paditësi ka filluar prape dhe me datë 14.11.2019 ka ushtruar revizion gjykatës supreme dhe gjykata supreme me aktgjykim te 66/2019 te datës 06.02.2020 c ka refuzuar si te pabazuar revizionin e paditësit kundër aktgjykimit te gjykatës se apelit dhe me këtë ka përfunduar procedura kontestimorë ne këtë çështje juridike me datë 09.03.2020. Kështu që ne nuk mundemi me lanë ne pafundësi tokën ne shfrytëzim atij dhe duhet me fillua procedurën e shkëputjes se kontratës se njëanshme.

Kryesuesi – Faleminderit z. Hoti, të nderuar kolegë a po pajtoheni që ta kemi pikë të rendit të ditës për mbledhje te kuvendit. Atëherë e quesim ne votim rendin e ditës me pikën shtesë. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës me pikën shtesë. Kalojmë ne pikën e parë të rendit te ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Prosesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush dícka sa i pěrket procesverbalit.

Fehmi Cena – Përshtendelje për te gjithë. Unë dua me bo një ndërhyrje te vogël tek faqe 2, tek diskutimi im në lidhjen me pikën Shqyrtimi i raportit financiar janar-qershori 2021, ku thotë: pastaj kodi 50103 largimi dhe deponimi i automjeteve ku planifikimi ka qenë 2000 dhe asnjë euro nuk është planifikuar, që ne fakt duhet të jetë arkëtuar. Pra, ky ishte kuptimi i fjalisë, kështu ju lusë ta përmirësoni këtë gabim.

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, atēherë meqë nuk kemi tjerë tē lajmëruar, e qesim nē votim pikën e parë tē rendit tē ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit te ditës. Kalojmë nē pikën e dytë tē rendit tē ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për ridestinimin e mjeteve të mbeturë nga buxheti i vitit 2021.

Afrim Limani – Përshtënjetje për ju kryesues dhe ju anëtarë te KPF-së. Ridestinimi i mjeteve financiare edhe pse si proces vazhdimi shështë paraqitur ne kuvend ne muajin tetor mirëpo për shkak te mungesës se rishikimit te buxhetit dhe nuk kemi pasur ndonjë leje për muajin qershor atëherë ne si drejtori e financave jemi detyruar që këtë proces ta kryejmë pikërisht ne këtë muaj me arsyetimin sepse muajt e tjerë jemi edhe me te angazhuar pasi e kemi edhe aprovin e buxhetit atëherë këtë pike te ridestinimit e kemi paraparë ne këtë scancë pra ne seancën e muajit gusht. Paraprakisht desha te ju informoj se dje kam pasur një takim me ministrinë e financave dhe mi kanë dhanë disa irregulla dhe udhëzime që nga ajo ka ndryshua edhe ky dokument, pra ka disa ndryshime te vogla me arsyetimin se mjetet te cilat ridestinohen duhet me qenë po nga ai fondi burimor, që supozojmë p.sh. nëse duam me ridestinue mjete nga te hyrat vetanake atëherë duhet te kalojnë ne atë fond burimor pra ne 21 dhe ne kemi pasur disa devijime dhe kjo çshëtë arsyjeja se edhe ky dokument ka ndryshua, kështu që unë e kam dokumentin e ri që e kemi përgatit dhe shqirish që permbledhjen e kuvendit do ta keni edhe ju si material. Pra ndryshimi ne total, pra ka një ndryshim te vogël që ka qenë 192,719 shume e ridestinuar që e kcni ju nc këtë dokument ndërsa tashi e keni 212,719 euro. Pra arsyjeja se ka qenë mire me lanë këtë dokument ne muajin teto mirëpo ne e kemi vepruar pikërisht këtë muaj sepse te paktën ne e kemi planifikimin real që këto mjete duhet te ridestinohen dhe për këtë arsyje e kemi qitë këtë dokument ne muajin gusht.

Fehmi Cena – Fillimish e falënderoj drejtorin për Financa për këtë sqarim dhe natyrisht se ne kemi nevojë për kësot sqarime sepse fjalë është për buxhet pasi shuma për ridestinim të parë do të ndryshon dhe ne duhet ta kemi atë material konkret për mbledhje te kuvendit dhe gjithashtu e sqaroj se komuna jonë nuk e ka bërë rishikimin në këtë vit të buxhetit dhe kjo në një farë mënyrë është në shërbim të asaj pasi me ridestinim rishikim. Pra, atë që kërkoj për mbledhje të kuvendit është që këto ndryshime të jenë të sakta dhe gjithashtu për këto ridestinime të projekteve që për një projekt që ka qenë i destinuar një pjesë e buxhetit nuk është realizuar dhe tash po bëhet ridestinimi në projektin tjeter dhe do të ishte mirë që për secilin projekt me qenë të përgatitur dhe me na sqarua se pse nuk është realizuar dhe tash po kërkohet një projekt tjeter dhe po ri destinohen mjetet për atë projekt. Kështu që ne duhet ta kalojmë për kuvend dhe atëherë e shqyrtojmë me hollësisht.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë juve. E para kam një vërejtje te vogël që me siguri ka qenë teknike pasi unë nuk e kam materialin e plotë dhe pikërisht për këtë pikë te rendit te ditës nuk e kam materialin e madje as në email adresë dhe aq sa kisha mundësi me lexua tani e kam një vërejtje te disa projekte që kanë ngecur apo më mirë me thanë që janë harruar siç është projekti për trotuarin ne aksin rrugor Malesi e Vogel- Gexhë pastaj obori i shkollës në Malësi të Vogël dhe plot projekte të tjera. Kështu që tash nuk e di a ka mungesë te mjeteve apo është problem operatori dhe tash pothuajse po kryhet mandati dhe nuk e shoh askund që ka ndonjë shenjë që do te kryhen këto punë për këtë vit dhe nëse kemi mungesë te mjeteve atëherë pse nuk kanë këqyrë ato njëherë me i krye sepse vërtet jep një pasqyrë jo të mirë edhe për qeverisjen aktuale sepse shihen skaj rrugëve, shihen si kriteri për punimet që janë për keqardhje. Prandaj deri sa është drejtori këtu do të ishte mirë me na sqa ruva se si qëndron puna me këto projekte dhe nëse ka mungesë të mjeteve me i transferua një pjesë të tyre në ato projekte.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa. Sa i përket çështjes së troiareve të premten është lidhur kontrata zyrtarisht edhe punimet fillojnë javën e ardhshme mirëpo kemi shumë pozicione që do të kryhen dhe llogariten afér 14 km troiare ne tërë territorin e komunës së Rahovecit. Ne tani do të fillojmë në dy pozicione në fshatin Pastasel dhe njëra ne fshatin Malësi e Vogel dhe kompania ka përfitua kontratën për këto dy projekte edhe pse megjithëse nuk ka mjete sa duhet por punimet do të fillojnë dhe besoj që do të kryhen sipas afatit dhe dinamikës së punimeve që janë në kontratë. Kjo është ajo që është planifikuar edhe pse nuk kemi mjete sa duhet pasi diku janë afér 40,000 euro gjithsej por kompania ka shprehur gatishmërinë me fillua punimet dhe me përfundua këto segmente rrugore.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për të gjitha sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e dytë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e tretë te rendit te ditës:

3. Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike ne Komunën e Rahovecit.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, tani po ju jap një informatë për planin 5-vjeçar që e kemi rreth hapësirave publike që ka qenë një plan i aprovuar para 5 vite nga Demos ne bashkëpunim me Komunën e Rahovecit, që përfundon ne dhjetor te vitit 2021 ky plan 5 vjeçar dhe shpresojmë që ne vitin e ardhshëm te fillojmë me procedurën e re për planin e ri te hapësirave publike. Ne kemi dhënë një informatë ku e keni te shkruar ne detaje ne disa pozicionc që komuna e Rahovecit ka marr përsipër që përmes kontratave për implementimin e këtyre hapësirave. Në këtë vite ka pasur disa ndryshime për shkak të disa planifikimeve që janë bërë ne zyrën e prokurimit që janë futur edhe disa elemente tjera si p.sh. siç është rasti i drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim ne mirëmbajtjen e shtigjeve te ecjes, po ashtu ne kemi për këtë vit edhe 3 kontrata që vazhdojnë edhe për vitin e ardhshëm që kapin vlerën afersisht 108,000 euro për te tri kontratat dhe janë te përfshira te gjitha pozicionet siç e shihni e�he ne raport mirëmbajtjen e gjelbërimit hapësira për parkim ndriçime publike varreza lapidare pllaka përkujtimore. Tani nuk do te zgjatem me shume mirëpo nëse ka dikush ndonjë pyetje atëherë do tc mundohem te jap përgjigje për ndonjë kërkcesh do tc japim sqarime këtu tani e po ashtu edhe ne seancën e rregullt te kuvendit.

Fehmi Cena - Ky plan për mirëmbajtjen e hapësirave te hapura publike ne komunën tonë për vitin 2016-2021 është bërë në qeverinë e mëhershme para mandatit të kësaj qeverie, po ashtu e kemi përmendur edhe herëve tjera nëpër mbledhje, kjo që thuhet ka ndihmuar edhe Demosi komunën, atëherë me intereson me ditë që Demosi a ka ndihmuar edhe ne mënyrë financiare ndonjë projekt në këtë drejtim apo vetëm ne mënyrë profesionale. Gjithashtu ju e përmendet që ky plan do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm ndërsa thuhet se plani është për vitin 2016-2021, pra kisha dashtë me qartësua këtë pasi a do të vazhdon apo do të përmbyllët në këtë vit dhe pastaj do të bëhet plani tjetër, kërkoi këtë sqarim nga ju.

Dervish Çadraku – Unë e kam një pyetje rreth kësaj, se a ka projekte për këto apo janë ndarë mjete të pastaj kur kemi nevojë me i pae, pra a ka projekte që ne mundemi me u thirre se do të ndërtohen ne vende të caktuara pasi shumë shpesh e kemi këto probleme neper mbledhje të kuvendit dhe kemi vazhdimisht këto vërejtje pasi nuk i kemi projektet e gatshme dhe më pastaj në baze të inercionit i bëjmë kudo qoftë.

Përparim Krasniqi – Plani 5 vjeçar është i ndarë paralelisht me kontratat që janë lidhur, për shkak se ne nuk mundemi me ndërpëre kontratën që me shkue baraspeshë me planin 5 vjeçar. Do të ketë risi vetëm ne bazë te

udhëzimeve te reja administrative që do te futen ne planin e ri, për shkak që ne baze te udhëzimeve administrative që vinë nga ministritë përkatëse dhe bëhet plani 5 vjeçar. Sa i përket çështjes se Demos, unë mund te ju them se Demosi ka pasur edhe projekte që kanë investuar ne komunën e Rahovecit siç është fjala përmugjen e UÇK-së që e ka financuar pastaj trotuarin ndriçimin publik drunjë dekorativ mirëpo tash edhe organizatat janë ndarë sipas zonave dhe Demosi nuk operon tani ne komunën e Rahovecit për shkak se është gjak që e ka përfshije rajonin e Prizrenit dhe nuk bëjnë tani investime ne infrastrukturë por vetëm bëjnë investime ne plane rregulluese, ndonjë mbështetje ne trajnime dhe gjëra tjera mirëpo ne aspektin infrastrukturor nuk bëjnë investime tani. Sa i përket pyetjes se parashtruar nga Dervish Çadraku rrëth çështijes se projekteve, disa drejtori kanë projekte ne implementimin e këtyre parqeve e sidomos drejtoria e urbanizmit dhe ne i marrim ato projekte dhe ne baze te projekteve që i implementojnë ata i fusim ne mirëmbajtje pasi që ky kodë është vetëm për mirëmbajtje te hapësirave publike dhe nuk është kodi i investimeve te hapësirave publike d.m.th. dallon kjo drejtori përkatëse pasi drejtoria e urbanizmit e bën implementimin e projektit ndërsa ne përmes këtyre kontratave e bëjmë vetëm mirëmbajtjen e hapësirave publike.


Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon përvend edhe pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Të ndryshme.

Dervish Çadraku – Kam pasur vërejtje edhe me herët, por e shoh edhe qytetarët e Kosovës në përgjithësi e ne veçanti edhe të komunës së Rahovecit kanë shumë probleme me vaksinim. Kërkoj të di se pse nuk i shpërndajnë këto edhe ne dy qendrat e QMF-së në Ratkoc dhe Krushë.

Samir Mustafa – Përhëndetje për ju dhe gjithë anëtarët e KPF-së. Në fillim kemi bërë kërkësë për hapjen e dy qendrave te reja te vaksinimit ne Ratkoc dhc Krushë te Madhe mirëpo kërkesa jonë është refuzuar nga ana e ministrisë se Shëndetësisë sipas tyre te mungesës se logistikës nga ana Ministrisë se Shëndetësisë, pasi komplet logistikën ne repartin e vaksinimit është nga Ministria e shëndetësisë pasi nuk kanë kapacitete as humane e as logistikë. Dhe sa për informatën ne komunën e Rahovecit deri me sot janë vaksinuar 20,905 qytetare kështu që trendi i vaksinimit është duke vazduar edhe pse kemi pak tollovi që krijohet nga fluksi i madhe i qytetareve që kërkojnë me u vaksinue dhe sigurisht që janë rrët kërkësat për vaksinim, ku mesatarisht vaksinohen 700 qytetarë në ditë edhe përkundër kërkësës nga ana e ministrisë se shëndetësisë që një ekip shëndetësorë duhet të i vaksinoj 60 qytetarë në ditë mirëpo ne QKMF te Rahovecit secili ekip shëndetësore i vaksinon minimumi 90 qytetarë, pra të gjitha parashikimet i tejkalon ekipet shëndetësore dhe janë për çdo lavdatë.

Kryesuesi – Faleminderit për informatën drejtor, të nderuar kolegë anëtarë të KPF-së, nënkyetar, drejtorë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë.

Proçesmbajtësi,

Agim Hoti

